

PROGRAMI I CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT

MASTER PROFESIONAL NË “MËSUES NË ARSIMIN FILLOR”

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë Universitare Master Profesional në “Mësues në Arsimin Fillor”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Ne proces akreditimi
Cikli i studimit	Program i Ciklit i dytë të studimit
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	1. Pranimi i studentëve në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses një program të ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, i cili jep akses në programet e ciklit të dytë të studimeve, në fushën e mësuesisë. 2. Kriter pranimi në këtë program të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” është njohja nga kandidati e një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit European: (<i>anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht</i>), në nivelin B₁, sipas akteve nënligjore të MAS-it. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

	Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë, Universiteti “Eqrem Çabej”	a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “Bachelor” në Mësues i Arsimit Fillor dhe “Bachelor” në Mësues i Arsimit Parashkollor. b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, në programe studimi të përfafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.
	Nga Institucione të Arsimit të Lartë, brenda vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, brenda vendit, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimi të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.
	Nga Institucione të Arsimit të Lartë, jashtë vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “Bachelor”, në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehsimin pranë MAS-it.
	3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës mesatare të ciklit të parë “Bachelor”, deri në plotësimin e kuotave të shpallura. Në rast se numri i aplikimeve kalon kuotën e parashikuar të pranimeve nga Njësia bazë, atëherë kandidatët do të seleksionohen sipas: a. Nivelit të përshtatshmërisë së diplomës “Bachelor” për vazhdimin e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” në Mësuesi në Arsimin Fillor. Notës mesatare në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”.	

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Mesuesi Arsimit Fillor”, është të thellojë njohuritë dhe shprehjet e marra nga të diplomuarit në ciklin e parë të formimit si mësues për arsimin fillor, duke i pajisur ata me dijet dhe shprehjet e nevojshme, shumëplanëshe dhe të shumëllojta, për të drejtuar me sukses procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve të fëmijëve për të qenë qytetarë aktivë të shoqërisë demokratike.

Ky program studimi synon të aftësojë studentët si mësues profesionistë të arsimit fillor. Të diplomuarit, në përfundim të këtij cikli të studimit, pajisen me aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe praktike që lidhen me fushën e edukimit në arsimin fillor; me kompetenca të përgjithshme për jetë dhe punë, si dhe zhvillojnë kompetencat e duhura për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur; për strukturimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për qëllime të caktuara; qëndrimin kritik ndaj tyre dhe aftësimin në zgjidhjen e problemeve në situata praktike; të zotërojnë botën e sotme dixhitale; të ndërtojnë dhe zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria.

Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë, duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

Të diplomuarit në përfundim të ciklit të studimit:

- Pajisen me aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe praktike që lidhen me fushën e edukimit në arsimin fillor.
- Pajisen me kompetencave të përgjithshme për jetë dhe punë që zhvillojnë kompetencat e duhura për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur.
- Aftësohen të përcaktojnë se mbi çfarë baze do të zgjidhet përmbajtja e asaj që duhet të mësohet, si do të përzgjidhet ajo që është e rëndësishme nga bota e madhe e informacionit.
- Aftësohen për të dalluar dijet e domosdoshme dhe për të mbajtur qëndrime kritike ndaj këtyre dijeve.
- Pajisen me aftësi për të zgjidhur problemet në situatat praktike dhe me kompetenca të reja që i ndihmojnë të zotërojnë botën e sotme dixhitale.
- Aftësohen për të zbatuar strategji mësimore të diferencuara dhe të përshtatura për nxënësit e arsimit fillor.
- Aftësohen në përdorimin e formave të ndryshme të vlerësimit të nxënësve.
- Aftësohen në menaxhimin e klasës për nxënësit e arsimit fillor.
- Aftësohen në etiketë profesionale dhe të promovimit të një ambienti gjithëpërfshirës.
- Zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme, për të kontribuar në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare, si dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e Mësuesit të Arsimit Fillor. Objektivat e përmendura më lart dhe aftësi të tjera profesionale mbështetëse që ky program synon të realizojë, do të sigurojnë një performancë të lartë profesionale në mjedisin e klasave gjithëpërfshirëse të arsimit fillor.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të pedagogjisë dhe didaktikës së arsimit fillor, psikologjisë së zhvillimit dhe të nxënësve, metodologjisë së mësimdhënies për arsimin fillor, menaxhimit të klasës dhe të sjelljes, vlerësimit dhe monitorimit të të nxënësve të fëmijëve si dhe aftësi të teknologjisë edukative dhe mjeteve të mbështetjes mësimore. Ky program përfshin thellime në këto fusha, për të siguruar që mësuesit të jenë të aftë të përdorin metoda inovative dhe të efektshme në procesin e mësimdhënies, të zhvillojnë aftësi për të krijuar mjedise mësimore të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, të

përdorin teknologjitë më të fundit në mbështetje të të nxënit të fëmijëve, të aftësohen në mendimtarë kritikë dhe të pavarur për zgjidhjen e çështjeve të mësimdhënies, të komunikimit dhe të edukimit.

VEPRIMTARITË FORMUESE

- 1. Lëndë të formimit të përgjithshëm** (Zhvillim Kurrikule, Metodologji e mësimdhënies, Vlerësimi në arsim) **Kredite (12 ECTS).**
- 2. Lëndë të formimit karakterizues** (Motivimi dhe produktiviteti, Gjithëpërfshirja në arsim, Didaktika e gjuhës shqipe dhe leximit, Didaktika e artit pamor dhe skenik, Didaktika e matematikës Didaktika e shkencave të natyrës/ e diturisë së natyrës, Didaktika e shkencave shoqërore, Didaktika e edukimit fizik, Didaktika e muzikës)**Kredite (48ECTS).**
- 3. Lëndë integruese** (Administrim dhe legjislacion në arsim, Arsimi gjatë gjithë jetës dhe zhvillimi profesional, Mendim kritik dhe krijues, Menaxhim i klases, Metodat e kërkimit në edukim) **Kredite (28ECTS).**
- 4. Lëndë me zgjedhje** (Edukimi për sipërmarje Mjedisi dhe natyra) **Kredite(8 ECTS).**
- 5. Lëndë të formimit plotësues** (TIK në mësimdhënie,Praktikë profesionale) **Kredite (12ECTS).**
- 6. Detyrime përmbyllëse** (tezë diplome/provim përfundimtar) **Kredite (12ECTS).**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm: 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75-84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në ‘Mësues në Arsimin Fillor’, është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë profesionale është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit, duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj, detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë profesionale dhe akademike në fushën e arsimit, si dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për të kontribuar në përmirësimin e praktikave edukative dhe inovative në arsim.

Me diplomimin në programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Fillor”, studentëve dot’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia Bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, përfundimi i këtij programi të studimit, jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në programe të tjera të ngjashme të ciklit të dytë, Master i Shkencave, si dhe për vazhdimin e studimeve në një program të ciklit të tretë në doktoraturë, në të njëjtën fushë psikopedagogjike apo në një fushë të përafërt.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë / mësues në arsimin fillor në fushën e edukimit dhe të zhvillimit të fëmijëve, të mësimdhënies dhe të komunikimit, të planifikimit dhe hartimit të kurrikulave, të administrimit të politikave arsimore, etj., të kualifikuar me njohuri të tilla, si: metodologjitë e mësimdhënies, menaxhimi i klasës, vlerësimi i nxënësve, përdorimi i teknologjive edukative dhe krijimi i mjediseve gjithëpërfshirëse. Për këtë arsye, synimi i programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Fillor”, është përgatitja e të diplomuarve, të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Të diplomuarit nga ky program i nivelit të dytë, mund të punësohen në institucionet publike apo private të arsimit fillor; në pozicione të ndryshme mësimdhënëse, por edhe drejtuese; mësues, specialistë në administratën arsimore në fushën e arsimit, në institucione kërkimore që merren me çështje të edukimit etj. Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në:

1. Shkolla fillore publike dhe private, si mësues të arsimit fillor, ku do të aplikojnë metoda mësimore të diferencuara për të mbështetur zhvillimin e nxënësve.
2. Qendra edukative dhe rehabilituese, ku mund të ofrojnë mbështetje për nxënës që kanë nevoja të veçanta arsimore dhe zhvillimore.
3. Organizatajo-qeveritare, që merren me projekte edukative dhe zhvillimin e programeve për fëmijët, veçanërisht në kontekste sociale ose komunitete të marginalizuara.
4. Konsulencë dhe trajnim për mësues të tjerë, duke ofruar ekspertizë në zhvillimin e kurrikulave dhe metodologjive mësimore për arsimin fillor.
5. Pozicion administrative në institucione arsimore, koordinatorë të aktiviteteve mësimore dhe zhvillues programesh për arsimin fillor.

Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Fillor”, u ofron të diplomuarve me një diplomë të ciklit të dytë, njohuri të thelluara teorike dhe praktike profesionale në drejtimin ‘Mësues në Arsimin Fillor’. Ky program realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja është dy vite akademike; studentët në këtë program diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Në përfundim të studimit lëshohet diplomë Master profesionale në “Mësues në Arsimin Fillor”. Studentët, të cilët përfundojnë këtë program studimi, fitojnë njohuri në teorinë dhe praktikën psikologjike dhe pedagogjike, në metodologjitë dhe

didaktiken e mësimdhënies, në planifikimin mësimor, në përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve mësimore innovative, etj. bazuar në planin mësimor të këtij cikli studimi, si më poshtë:

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (*plani mësimor*)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i parë				
1.	ZhvillimKurrikule	4	100	II
2.	Metodologji e mësimdhënies	4	100	I
3.	Motivimidheproduktiviteti	6	150	I
4.	Gjithëpërfshirjanëarsim	6	150	I
5.	Didaktika e gjuhës shqipe dhe leximit	6	150	I+II
6.	Didaktika e artit pamor dhe skenik	5	125	I
7.	Didaktika e matematikës	6	150	II
8.	Administrim dhe legjislacion në arsim	6	150	II
9.	Arsimi gjatë gjithë jetës dhe zhvillimi profesional	6	150	I
10.	Mendim kritik dhe krijues	5	125	II
11.	Menaxhimi i klasës	6	150	II
Gjitsej viti i parë		60 ECTS	1500 orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Vlerësimi në arsim	4	100	II
2.	Didaktika e shkencave të natyrës (e diturisë së natyrës)	5	125	II
3.	Didaktika e shkencave shoqërore	5	125	I
4.	Didaktika e edukimit fizik	4	100	I
5.	Didaktika e muzikës	5	125	I
6.	Metodat e kërkimit në edukim	4	100	I
7.	Etika profesionale e mësuesit dhe komunikimi	5	125	I
8.	TIK në mësimdhënie	4	100	II
8.	Praktikëprofesionale	8	200	I+II
9.	Detyrimepërmbyllëse (tezëdiplome/provimpërfundimtar)	12	300	II
	Lëndë me zgjedhje: 1.Edukimi për sipërmarje 2.Mjedisi dhe natyra	4	100	I
Gjithsej viti i dytë		60	1500	
Totali i orëve Viti parë + Viti i dytë		120 ECTS	3000orë	

